



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni vjeshtor

Seanca jashtëzakonshme plenare e Kuvendit
P- 86/2
Prishtinë, më 17 tetor 2009
Ndërtesa e Kuvendit, sala e seancave plenare.

P R O C E S V E R B A L

**I SEANCËS SË JASHTËZAKONSHME PLENARE TË KUVENDIT TË
REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË MBAJTUR MË 17 TETOR 2009**

Seancën e drejtoi **Jakup Krasniqi**, Kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Xhavit Haliti**, anëtar i Kryesisë së Kuvendit.

Kryetari konstatoi se në sallë janë të pranishëm 87 deputetë dhe deklaroi të hapur punimet e seancës.

Kryetari i njoftoi deputetët Kryesia e Kuvendit të Kosovës, në marrëveshje me shefat e grupeve parlamentare, me kërkesë të Presidentit të Republikës së Kosovës dhe të Kryeministrit të Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 69, paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, vendosi që të thërres seancë të re të jashtëzakonshme plenare për:

- **Ratifikimin e Marrëveshjes për demarkacion fizik të kufirit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Maqedonisë**

Kryetari, ftoi kryeministrin e Republikës së Kosovës që ta marrë fjalën.

Kryeministri **Hashim Thaqi**, falënderoj deputetet për mirëkuptimin që treguar për të hyrë edhe në një seancë të jashtëzakonshme të ftuar nga Presidenti i Republikës së Kosovës, Fatmir Sejdiu dhe nga unë, si Kryeministër i Republikës së Kosovës, si seancë të jashtëzakonshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës për ta miratuar Marrëveshjen ndërshtetërore për demarkacionin fizik të kufirit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Maqedonisë. Në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe në zbatim të procesit të paraparë në nenin 3 të Aneksit VIII të Propozimit gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës të Presidentit Ahtisari, gjithashtu dëshiroj të theksoj se Qeveria e Republikës së Kosovës dje, me datë 16 tetor 2009, në orët e vona ka nënshkruar Marrëveshjen ndërshtetërore me Republikën e Maqedonisë për demarkacionin fizik të kufirit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Maqedonisë. Kryeministri ftoj për votim unanim në interes të shtetit të Kosovës dhe të qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Fjala e plot e Kryeministrit është dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverbali.

Kryetari hapi debatin për Marrëveshjes për demarkacion fizik të kufirit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Maqedonisë

Pasi që nuk pati të paraqitur për fjalë, as nga grupet parlamentare e as nga deputetet Kryetari e hodhi në votim për Ratifikim Marrëveshjen për demarkacion fizik të kufirit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Maqedonisë. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----81,
Kundër-----3,
Abstenime-----2.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash,

V E N D O S I

1. Ratifikohet Marrëveshja për demarkacionin fizik të kufirit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Maqedonisë.
2. Ngarkohet Qeveria e Republikës së Kosovës që t'i marrë të gjitha veprimet në zbatim të kësaj marrëveshje ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Maqedonisë.
3. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është teksti i Marrëveshjes për demarkacion fizik të kufirit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Maqedonisë.

Seanca i përfundoi punimet në orën **13: 50** minuta.

Kryetari i Kuvendit,
Jakup KRASNIQI

Përgatiti: **Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale**